



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

RrGGK kërkon hetimin e rastit skandaloz në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike të QKUK-së

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) e ka pranuar me shqetësim lajmin se një grua (S.K) ka lindur foshnjën e saj në korridorin e Klinikës Obstetrike Gjinekologjike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).

RrGGK shpreh shqetësimin lidhur me atë se qëndrimi i lehonës në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike pak minuta para lindjes, është shoqëruar me neglizhencë e ofendime nga stafi mjekësor. Ky grup i "mamive dhe mjekëve" duke mos e kryer punën e tyre sipas kontratës dhe betimit të Hipokratit, e kanë vënë në rrezik jetën e foshnjës dhe nënës.

Ne konsiderojmë se sjellja joprofesionale e stafit të kësaj klinike, ndaj pacientes S.K., përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe një vepër të rëndë penale.

Duke marrë parasysh se ky nuk është rasti i parë skandaloz që po ndodhë në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike të QKUK-së, RrGGK kërkon nga institucionet kompetente që të kryhet hetim i menjëhershëm i këtij rasti, dhe në rast se konfirmohen pretendimet, të ndërmerren masat përkatëse ndëshkuese ndaj personelit dhe menaxhmentit të kësaj klinike.

PRESS

www.womensnetwork.org • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000
Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 •
info@womensnetwork.org